



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRI E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE OKOLINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE	
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Vlera orig. Orig. Ref. No.	SP-02
Vlera orig. Orig. Ref. No.	4124-2/25
Nr. Fajevë Pr. Stranica	-05-
Nr. Fajevë Pr. Stranica	01.09.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	04.08.2025
REFERENC-Ë:	25/4124/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Osmanaj Group" Shpk Gjurakoc, Istog
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 25/4124/277/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në draft vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

- Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Osmanaj Group" Shpk Gjurakoc, Istog - për Fabrikën për prodhimin e kubëzave dhe elementeve nga betoni, Linja 1 dhe Linja 2 në Gjurakoc, Komuna e Istogut.
- Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Pajiset me Pëlqim Mjedisor Kompania "Osmanaj Group" Shpk Gjuraroc, Komuna e Istogut - për fabrikën për prodhimin e kubëzave dhe elementeve nga betoni, Linja 1 dhe Linja 2 në Gjuraroc, Komuna e Istogut në ngastrën kadastrale Nr. P-70806016-01213-1 dhe P-70806016-01213-2 në ZK. Gjuraroc dhe në ngastrën kadastrale P-70806020-00970-1 dhe P-70806020-00970-2 ZK Zallq, Komuna Istog nën kushtet si vijon:

- Të bëhet betonimi dhe izolimi i platos ku janë të vendosura pajimet për prodhimin e betonit, elementeve të betonit dhe thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, si dhe të tëra sipërfaqet funksionale;
- Të vendoset sistemi për trajtimin e ujërave industriale dhe ujërave atmosferike të cilat krijohen në sipërfaqet operationale gjatë të reshurave (sedimentuesit dhe separatori për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga uji), para shkarkimit të tyre;

- Të bëhet betonimi dhe izolimi i platos së depos ku vendosën fuqitë e vajrave dhe derivateve, si dhe mbeturinat nga nënproduktet e krijuara gjatë procesit të prodhimit dhe larjes së auto mikserëve;
- Të bëhet monitorimi i përhershëm i filtrave të pluhurit, të dëmtuarit të ndërrohen;
- Të bëhet mbyllja hermetike e gypave dhe kanaleve për përcjelljen (transportin) e çimentos, të izolojnë të gjitha pikat gjeneruese të pluhurit.
- Të bahet monitorimi i emisioneve të pluhurit dhe ujërave që shkarkohen në mjedis;
- Rezultatet e kryera laboratorike të i raportohen MMPHI-së, në bazë të kërkesave;
- Të vendosen pajimet adekuate për deponimin e mbeturinave të ngurta dhe lëngëta;
- Të bëhet nivelizimi, gjelbërimi i terenit dhe rregullimi i rrethojës së terenit afër vendëpunishtës;
- Bazuar në Ligjin e Ujërave Nr.04/L-147, neni 48, pika 1 dhe 1.3, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Ndalohet veprimtaria e Kompanisë në largësi jo më pak se tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij;
- Të bëhet thurra e ngastrës me tel gjëmbor.

Aplikuesi përpos kushteve të lartshënuara duhet të u përmbahet edhe kushteve të paraqitura në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar nga Kompania "Osmanaj Group" Shpk Gjirakoc, Komuna e Istogut - Fabrikën për prodhimin e kubëzave dhe elementeve nga betoni, Linja 1 dhe Linja 2 në ngastrën kadastrale Nr. P-70806016-01213-1 dhe P-70806016-01213-2 në ZK. Gjirakoc dhe në ngastrën kadastrale P-70806020-00970-1 dhe P-70806020-00970-2 ZK

Zallq, Komuna Istog, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqimit Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.
03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.
08/L-181

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt
administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të
njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 24/4124/ - ZSP/ /25 datë: 04.08.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. *Parashtruesit të kërkesës*
2. *Komisionit për VNM*
3. *Inspektoratit*
4. *Kabinetit të Ministrit*
5. *Komunës së Suharekës*
6. *Divizionit për komunikim me publikun*
7. *Arkivit të MMPHI*

Izedin Bytyqi

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI



2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.